

Të dhënat bazë të lëndës	
Njësia Akadematike:	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi:	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri
Titulli i lëndës:	Historia e Dizajnit dhe Mobilieve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi - ECTS:	4
Mësimdhënësi i lëndës:	Ligj. Msc. Bujar Jashari
Detajat kontaktuese:	bujar.jashari@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton njohuritë bazë rreth dizajnit si koncept. Përkufizimi i dizajnit dhe zhvillimi i tij në shkolla të ndryshme. Njohuri rreth historikut të dizajnit dhe dizajnit të mobilieve sot. Fokuset kryesisht në parimet bazë të konceptimit dhe dizajnit të mobilieve në periudha të ndryshme kohore. Trajtohen të gjitha stilet e mobilieve, bazuar në stilet më të njohura të arkitekturës. Arkitektura e interierit sipas epokave të ndryshme historike. Mobiliet e gjetura dhe përshkrimi i tyre bazuar në relievet e ndryshme. Materialet që janë përdorur për mobilie dhe interierin në përgjithësi.
Qëllimet e lëndës:	Lënda synon përgatitjen e studentëve me njohuritë e nevojshme rreth historikut të dizajnit në përgjithësi dhe aplikimin e dizajnit për mobilie. Ka për qëllim kryesor aftësimin lidhur me vlerësimin e stileve të mobilieve sipas stileve të njohura të arkitekturës. Vlerësimin e mobilieve sipas materialeve të përdorura për realizimin e tyre. Njohjen me teknikat e realizimit të mobilieve në periudha të ndryshme të historisë, përfshirë aspektin ekonomik, ergonomik dhe ekologjik.

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të lëndës studenti duhet të njohë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konceptet e përgjithshme të dizajnit; • Historikun e dizajnit dhe aplikimin e tij për dizajnimin e mobilieve dhe interierit; • Dizajnimi i mobilieve në periudha të ndryshme kohore dhe dallimet kryesore; • Format dhe detajet që përbëjnë një stil të caktuar; Stilet e mobilieve bazuar në konceptet e stileve në arkitekturë dhe periudha të ndryshme historike; • Të identifikojë dhe përshkruajë një stil të caktuar, përfshirë aspektet kryesore të identifikimit, materialet e përdorura, teknikat e realizimit, periudhën kohore kur është realizuar; • Si kanë evoluar mobilet dhe interieri përgjatë historisë, duke konsideruar, shtresat shoqërore që kanë pasur mobilie, aspektet ergonomike të mobilieve dhe madhështia e tyre dikur. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mesimdhënësit konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	3	3	9
Kollokiume - seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			15
Përgatitja përfundimtare në provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet	1	3	3
Totali			101
Metodologjia e	Ligjërata të kombinuara me shembuj konkret		
Metodat e vlerësimit:	Punim seminarik (Projekt Kursi) 30% Provimi përfundimtar 70%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Furniture Dizajn (2015), Jerzki Smardzewcki, Poznan University of Life Sciences, Poland. 2. Bruno Zevi, Historia e arkitekturës moderne, 2012.		
Literatura shtesë:	3. Billcliffe R. (2010). Charles Rennie Mackintosh : the complete furniture, furniture drawings & interior designs, Abrams in association with Cameron & Hollis, New York.		
Plani i dizajnuar i mësimit:			

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi syllabusit, historiku i dizajnit dhe koncepte të përgjithshme rreth tij.
Java e dytë:	Shkolla dhe teknika të ndryshme të dizajnit dhe aplikimi i tij në dizajnin e mobilieve.
Java e tretë:	Dizajnimi i mobilieve në periudha të ndryshme kohore dhe dallimet kryesore.
Java e katërt:	Historik, gjetjet më të hershme të mobilieve.
Java e pestë:	Mobilia egjiptiane, mobiliet e Egjiptit të lashtë.
Java e gjashtë:	Mesjeta, mobiliet indiane.
Java e shtatë:	Mobilia greke. Mobiliet e Greqisë së vjetër.
Java e tetë:	Mobilia romake, të Romës së lashtë.
Java e nëntë:	Mobiliet në periudhën e Rilindjes, mobilia moderne.
Java e dhjetë:	Mobiliet e stilit Barok dhe Rokoko
Java e njëmbëdhjetë:	Mobiliet Klasike dhe stilit Perandorak
Java e dymbëdhjetë:	Mobiliet e stilit Biendermeier dhe Eklektike
Java e trembëdhjetë:	Mobiliet e zanatlinjve dhe Artit të Ri
Java e katërbëdhjetë:	Mobiliet e Modernizmit dhe Post-Modernizmit
Java e pesëmbëdhjetë:	Mobiliet e shekullit XXI dhe tendencat

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria e rregullt dhe aktivizimi gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve janë të obligueshme.